



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Nr 9 Prot.

Vlorë, më 11 .09 . 2018

VENDIM

Nr. 4 _ Data 29.08.2018 _

Për shtyrjen e vendimit në mbledhjen e rradhës të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujor në lumin e Kardhiqit , dega e lumit Drino, për ndërtimin e hidrocentralit “Ferko 1” për prodhim të energjisë elektrike, Fshatin Çepu , Bashkia Gjirokastrë, Qarku Gjirokastrë, subjektit “SUFER” sh.p.k., me administrator Z. Ferit SUKAJ.

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", formulari D, dokumentacioni teknik, Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta", Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor”, Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Ujor”; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, shkresës zyrtare të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, **Nr. 526, datë 21.10.2016 “Vënie në dijeni”**,

VENDOSI

Për shtyrjen e vendimit në mbledhjen e rradhës të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujor në lumin e Kardhiqit , dega e lumit Drino, për ndërtimin e hidrocentralit “Ferko 1” për prodhim të energjisë elektrike, Fshatin Çepu , Bashkia Gjirokastrë, Qarku Gjirokastrë, subjektit “SUFER” sh.p.k., me administrator Z. Ferit SUKAJ me këto të dhëna:

Koordinatat: X 44 10 030; Y 44 45 820; Z 554

Prurja mesatare : 1.100 m³/sek

Prurja e llogaritur: 1.300 m³/sek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Prurja e ekologjike: 0.125 m³/sek

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritet të jetë **1060 kW**

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U "VJOSË"

Ilir PROFKA

KRYETAR I K.B.U "VJOSË"

Flamur MAMAJ

